Vendim nr. 288 datë 16.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 16.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (N) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **NEFAIL KISHTA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 5323, datë 23.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 731, datë 22.02.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 18 dhe 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta);* ligji nr. 9210, datë 23.03.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" (*ligji nr. 9210/2004*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka shërbyer si oficer në garnizonin e Kukësit prej vitit 1979 deri në vitin 1991, ku ka qenë i strehuar në një apartament banimi. Në vitin 1991 ai është transferuar në qytetin e Pogradecit, ku ka shërbyer deri në vitin 2000. Gjatë kësaj periudhe, sipas kërkuesit,

atij do t'i jepej një shtëpi banimi, nga ana e garnizonit në Pogradec, por nuk është pajisur me këtë apartament. Nga vërtetimi nr. 437 prot., datë 29.01.2015 rezulton se në emër të kërkuesit, bashkëshortes dhe vajzës së tij nuk figurojnë pasuri të paluajtshme në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec (*ZVRPP*). Sipas vërtetimit nr. 193 prot., datë 28.01.2015 të Bashkisë Pogradec, kërkuesi është banor në Pogradec, ndërsa sipas vërtetimit nr. 47 prot., datë 27.02.2015, të lëshuar nga Bashkia Pogradec, ai figuron si i pastrehë.

2. Kërkuesi i është drejtuar me kërkesë palës së paditur, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, për t'u trajtuar me kredi për strehim. Me shkresën nr. 1074 prot., datë 14.02.2011, ky i fundit i ka kthyer përgjigje se Ministria e Mbrojtjes ka kompetencë për trajtimin e kërkesave për dhënie kredie dhe sigurim për strehim, duke e njoftuar se çështja i është përcjellë asaj ministrie për trajtim.

3. Me shkresën nr. 1/2 prot., datë 06.02.2014, Ministria e Mbrojtjes i ka kthyer përgjigje kërkuesit se me urdhrin nr. 1743, datë 25.11.2008 të ministrit të Mbrojtjes, ai nuk ishte përfshirë në listat e personave të trajtuar me kredi për strehim.

4. Në këto kushte, kërkuesi në datën 04.12.2014 i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pretenduar detyrimin e palëve të paditura ta trajtojnë atë me strehim ose me kredi për strehim.

5. Me vendimin nr. 280, datë 23.01.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes civile nr. 16256/3788 akti dhe dërgimin për shqyrtim të kërkesëpadisë dhe akteve shoqëruese Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pas ankimit të ushtruar nga kërkuesi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-2117, datë 24.06.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 280, datë 23.01.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Ndërkohë, në datën 15.05.2015 kërkuesi ka paraqitur padi tjetër në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin nr. 4423 (980-2015-2717), datë 14.09.2015, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, për shkak të gjyqvarësisë, pasi padia ishte ngritur njëherësh në dy gjykata.

7. Lidhur me padinë e parë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5323, datë 23.10.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke çmuar se kërkimet e kërkuesit janë të pabazuara në prova dhe në ligj. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kërkuesi e ka bazuar padinë në ligjin nr. 7496, datë 03.07.1991 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura" (*ligji nr. 7496/1991*), por në kohën e ngritjes së padisë nuk ishte më pjesë e Forcave të Armatosura dhe e kishte humbur statusin e ushtarakut aktiv me daljen në lirim. Sipas gjykatës së shkallës së parë, çdo e drejtë e parashikuar nga ky ligj nuk i

përkiste më kërkuesit pas daljes në lirim. Ajo gjykatë ka theksuar, gjithashtu, se neni 22 i këtij ligji parashikon të drejtën e ushtarakëve për strehim dhe jo për kredi për strehim. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për përfitimin e strehimit ose të kredisë për strehim në bazë të VKM-së nr. 452, datë 09.04.2004 (*VKM nr. 452/2004*), gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se kjo VKM ka hyrë në fuqi pasi kërkuesi kishte dalë në lirim. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar, gjithashtu, se procedura përfundon me aktin e ministrit të Mbrojtjes për miratimin e listave të personave të propozuar nga komisioni përkatës. Në vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, nëse kërkuesi nuk ishte dakord me vullnetin e shprehur nga ministri i Mbrojtjes, duhej të kundërshtonte aktin administrativ të tij dhe jo të kërkonte detyrimin e organit publik të kryente një veprim tjetër administrativ. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

8. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 731, datë 22.02.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke arsyetuar se në ankim kërkuesi nuk kishte parashtruar asnjë shkak tjetër, përveç atyre që kishte ngritur në gjykimin në shkallë të parë, ndaj ka marrë në shqyrtim po ato pretendime. Gjykata e apelit ka vlerësuar se kërkuesi kishte dalë në lirim në datën 31.05.2000, ndërsa padinë objekt shqyrtimi e kishte paraqitur në datën 09.12.2014. Sipas asaj gjykate, në kohën e ngritjes së padisë kërkuesi nuk ishte më pjesë e Forcave të Armatosura prej 14 vjetësh dhe e kishte humbur statusin e ushtarakut aktiv me daljen në lirim. Lidhur me VKM-në nr. 452, datë 09.04.2004, gjykata e apelit ka arsyetuar se ajo kishte hyrë në fuqi kur kërkuesi kishte katër vjet që kishte dalë në lirim dhe se ishte nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit nr. 9210/2004, i cili nuk kishte qenë në fuqi gjatë kohës që kërkuesi ishte pjesë e Forcave të Armatosura. Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur rekurs kërkuesi.

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin 00-2025-4504, datë 11.12.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur, duke arsyetuar se rekursi i paraqitur nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ekzistenca e të cilave mund ta bënte të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Ai kolegj, në respekt të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si dhe në mbështetje të nenit 473/a të Kodit të Procedurës Civile, nga vlerësimi i rrethanave të mosmarrëveshjes objekt gjykimi të konstatuara prej gjykatave të faktit, ka vlerësuar se në rekurs nuk është parashtruar asnjë argument i qenësishëm që të lidhet me një nga shkaqet për të cilat mund të ushtrohet e drejta e rekursit dhe se nuk është as rasti për të vënë në diskutim ndonjë çështje ligjore që mund të shqyrtohet kryesisht nga gjykata.

10. Në datën 30.04.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 09.06.2026.

11. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

12. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

12.1. *E drejta për dëmshpërblim*, pasi mosveprimi i organeve shtetërore për t'i siguruar kërkuesit strehim përbën dëm të drejtpërdrejtë për të cilin ai nuk është kompensuar, në kundërshtim me dispozitat kushtetuese.

12.2. *Barazia përpara ligjit*, pasi ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë me ushtarakët e tjerë, që janë në kushte të ngjashme, të cilët kanë përfituar nga legjislacioni në fuqi.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

13. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Po kështu, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së tyre, me pasojë moskalimin e çështjes

për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Mbi këtë bazë, Kolegji, në vijim, do të verifikojë vetëm kriterin e legjitimimit *ratione materiae* të kërkuesit.

15. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për dëmshpërblim, pasi mosveprimi i organeve shtetërore për t'i siguruar kërkuesit strehim përbën, sipas tij, dëm të drejtpërdrejtë për të cilin nuk është kompensuar, në kundërshtim me dispozitat kushtetuese.

16. Kolegji, referuar akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, vëren se kërkuesi i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me padi për trajtimin e tij me strehim ose kredi falas për strehim. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka gjetur padinë të pabazuar në prova dhe në ligj, duke arsyetuar se ndonëse kërkuesi e kishte mbështetur atë në ligjin nr. 7496/1991, në kohën e ngritjes së padisë nuk ishte më pjesë e Forcave të Armatosura dhe e kishte humbur statusin e ushtarakut aktiv me daljen në lirim. Gjithashtu, ajo gjykatë ka theksuar se neni 22 i këtij ligji parashikonte të drejtën e ushtarakëve për strehim, por jo për kredi për strehim, ndërsa VKM-ja nr. 452/2004 kishte hyrë në fuqi pas daljes në lirim të kërkuesit. Po kështu, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se procedura për trajtimin me kredi për strehim përfundonte me aktin e ministrit të Mbrojtjes për miratimin e listës së personave të propozuar nga komisioni përkatës dhe se, nëse kërkuesi çmonte se ishte cenuar në të drejtat e tij nga mospërfshirja në këtë listë, ai duhej të kundërshtonte gjyqësisht aktin administrativ të miratuar nga ministri. Sipas asaj gjykate, kërkuesi, në vend që të kundërshtonte këtë akt, kishte kërkuar detyrimin e organit publik për të kryer një veprim administrativ, konkretisht për t'i dhënë kredi për strehim, ndonëse ministri kishte shprehur tashmë vullnetin e tij me nxjerrjen e aktit administrativ përkatës. Për rrjedhojë, ajo gjykatë ka vlerësuar se padia e ngritur nga kërkuesi nuk i përgjigjej situatës ligjore dhe faktike konkrete.

17. Ky qëndrim është çmuar i drejtë nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka vlerësuar se në kohën e ngritjes së padisë kërkuesi nuk gëzonte më statusin e ushtarakut aktiv dhe se ligji nr. 9210/2004, në bazë të të cilit ishte nxjerrë VKM-ja nr. 452/2004, nuk kishte qenë në fuqi gjatë kohës që ai ishte pjesë e Forcave të Armatosura. Kurse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012.

18. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se gjykatat e zakonshme, në përputhje me kompetencat e tyre dhe në zbatim të dispozitave materiale dhe procedurale gjatë procesit gjyqësor, kanë analizuar çështjet e shtruara për zgjidhje përpara tyre dhe i kanë dhënë kërkuesit përgjigje të arsyetuar për kërkimet e tij, duke treguar mënyrën sesi janë përcaktuar faktet e

mosmarrëveshjes, sesi është interpretuar ligji i zbatueshëm dhe sesi kanë arritur në përfundimet përkatëse. Në këtë drejtim, ato kanë arsyetuar lidhur me mungesën e statusit të ushtarakut aktiv të kërkuesit në kohën e ngritjes së padisë, si dhe i kanë dhënë përgjigje pretendimit për zbatimin e VKM-së nr. 452/2004, duke arsyetuar se ky akt kishte hyrë në fuqi pas daljes në lirim të kërkuesit dhe, për këtë arsye, nuk ishte i zbatueshëm ndaj tij. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, në përputhje me funksionin e saj si gjykatë ligji, ka vlerësuar se rekursi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, ekzistenca e të cilave mund ta bënte të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Në këto rrethana, arsyetimi i gjykatave të zakonshme nuk rezulton haptazi arbitrar në kuptimin kushtetues.

19. Kolegji vëren, gjithashtu, se gjykata e shkallës së parë i ka dhënë përgjigje kërkuesit edhe për sa i përket mjetit gjyqësor që duhet të përdorte për kundërshtimin e mosmarrjes së përfitimit të pretenduar prej tij, duke arsyetuar se ai duhej të kundërshtonte aktin administrativ përkatës të ministrit të Mbrojtjes. Në këto rrethana, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për dëmshpërblim, i mbështetur në mosveprimin e organeve shtetërore për sigurimin e strehimit, nuk shoqërohet me argumente që vënë në dyshim përfundimet e gjykatave të zakonshme dhe, për rrjedhojë, është haptazi i pabazuar.

20. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, pasi nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me ushtarakët e tjerë, të cilët ndodheshin në kushte të ngjashme me të dhe kishin përfituar nga legjislacioni në fuqi.

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se barazia përpara ligjit, e sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës, nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë *(shih vendimet nr. 5, datë 13.02.2024; nr. 70, datë 27.12.2023; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj se procesi i gjykimit kushtetues është i natyrës argumentuese, çka nënkupton se u takon palëve të parashtrojnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre *(shih vendimet nr. 57, datë 25.07.2017; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 45, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka parashtruar argumente të mjaftueshme në mbështetje të pretendimit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, por është mjaftuar me argumente me natyrë të përgjithshme. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

22. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.